



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Prilato Received/Delivroy	20.01.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Mr Prof Br Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHËRBIMET	587/2023		116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1118/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari – kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1038/2022 të datës 22.11.2022 të ankueses [redacted] ankesën me numër A.nr.1054/2022 të datës 24.11.2022 të ankuesit [redacted] dhe ankesën me numër A.nr.1118/2022 të datës 08.12.2022 të ankuesit [redacted] të bashkuara në një ankesë me numër A.nr.1118/2022 përmes Vendimit VK.Nr.198/2022 të datës 30.12.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.01/016/01-0097492/2022 të datës 09.09.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës, në çështjen juridike "masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1118/2022 e datës 08.12.2022 e parashtruar nga ankuesit [redacted].

II. Anulohet Vendimi me Nr. 01/016/01-0097492/2022 i datës 07.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës për ankuesit [redacted] dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.

III. Obligohet Komisioni Disiplinor në Komunën e Pejës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndër marr të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ndaj ankueseve të gjithë të punësuar në Komunën e Pejës më datë 09.09.2022 ndaj tyre është inicuar procedurë disiplinore pranë Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës për shkak se të njëjtit nuk janë paraqitur në punë prej datës 11.08.2021 deri më datën 10.09.2021 pasi që kanë qenë në arrest shtëpiak.

Ankuesja Udhëheqëse e Njësisë ligjore –teknike dhe për Leje të Ndërtimit përmes postës me datë 22.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01/016/01-009749/2022 të datës 07.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim i gabuar i ligjit material.

Ankuesi i punësuar ne Komunën e Pejës në pozitën Inspektor i Ndërtimit me datë 24.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01/016/01-009749/2022 të datës 07.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim i gabuar i ligjit material.

i punësuar në Komunën e Pejës, në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit 06.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me date 08.12.2022 kundër Vendimit me Nr. 01/016/01-009749/2022 të datës 07.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim i gabuar i ligjit material.

Duke pas parasysh së ankesat bazohen në të njëjtën gjendje faktike dhe bazë ligjore, e në funksion të vendosjes në pajtim me parimin e efikasitetit të procedurës administrative siç përcaktohet me nenin 10 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me Vendimin VK.Nr.198/2022 të datës 30.12.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është bërë bashkimi i ankesave në një ankesë me numër A.nr. 1118/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 13.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Pejës. Ndërsa Këshilli me datën 21.12.2022 ka pranuar nga Komuna e Pejës përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 7774/2022 të datës 08.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 01/016/01-009749/2022 të datës 07.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës; Fletë dorëzimi i datës 11.11.2022; Zarfina e datës 08.12.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.12.2022 me numër protokolli 8009/2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 8271/2022 e datës 21.12.2022; Akt emërimi i datës 06.04.2020; Aktvendim i datës 07.04.2021; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore e datës 09.09.2022; Akt Emetimin e datës 04.01.2012 për ankuesen; Raportin mbi aktivitetet e realizuar prej datës 15.07.2021 deri më datë 10.09.2021; Aktvendim i datës 14.08.2021 i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 12.09.2022; Fletëdorëzimin e datës 11.11.2022; Kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit

PP/I Nr.144/2021 e datës 16.07.2021 nga Prokuroria Themelore në Pejë për Gjykatën Themelore në Pejë. Kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit PP/I Nr.144/2021 e datës 12.08.2021 nga Prokuroria Themelore në Pejë për Gjykatën Themelore në Pejë dhe Kërkesë e datës 26.08.2022 nga Policia e Kosovës; Ankesën me numër protokollit 7309/2022 të datës 22.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 01/016/01-0097492/2022 të datës 07.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës; Zarin e datës 18.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 7538/2022 e datës 01.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 7765/2022 e datës 08.12.2022; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore e datës 09.09.2022; Akt Emetimin e datës 04.01.2012 për ankuesen; Raportin mbi aktivitetet e realizuar prej datës 15.07.2021 deri më datë 10.09.2021; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 12.09.2022; Fletë dorëzimit e datës 11.11.2022; Kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit PP/I Nr.144/2021 e datës 16.07.2021 nga Prokuroria Themelore në Pejë për Gjykatën Themelore në Pejë; Ankesa A.nr. 1054/2022 e të datës 24.11.2022 me numër protokollit 7372 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë të datës 08.12.2022 me numër protokollit 7766/2022; Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore të datës 09.09.2022; Vendim i datës 07.10.2022; Raporti i monitorimit i datës 15.07.2021-10.09.2021; Procesverbali i Komisionit Disiplinor të datës 12.09.2022 me numër 01-016/01-0097492/2022; Flete dorëzimi i datës 18.11.2022 me numër 01-112/01-0097/483/2022; Kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit i datës 12.08.2021 me numër 144/2021; Aktvendim i datës 14.08.2021 me numër 128/21; Akt Emërim i datës 21.01.2018; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 22.11.2019;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *SEPSE*:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se ankuesit në bazë të Akt emërimeve janë të punësuar në Komunën e Pejës ne pozitë e punës si ne vijim në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit, në pozitën Inspektor i Ndërtimit dhe Udhëheqëse e Njesisë Ligjore-Teknike dhe për Leje të Ndërtimit. Më datë 09.09.2022 përmes Menaxherit të Personelit ndaj tyre është inicuar procedurë disiplinore pranë Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës për shkak se të njëjtit nuk janë paraqitur në punë prej datës 15.07.2021 deri më datën 10.09.2021 pasi që kanë qenë në arrest shtëpiak.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Pejës, më datë 07.10.2022 ka nxjerr vendime të ndara veç e veç por të gjitha me numër protokollit të njëjtë gjegjësisht me numër Nr.01/016/01-0097492/2022 përmes të cilave vendime ankuesve veç e veç ju ka shqiptuar masën disiplinore "*ndalimi i 20% e pagës për periudhën dy (2) muaj*", me arsyetimin se të njëjtit kanë bërë shkelje për shkak që kanë munguar në punë prej datës 11.08.2021 deri më datë 10.09.2021 për shkak të masës së arrestit shtëpiak.

Ankuesit në ankesat e parashtruara në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë që Vendimi me Nr. 01/016/01-0097492/2022 të datës 07.10.2022 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Pejës është nxjerr si rezultat i shkeljeve të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për faktin që nuk ka mundur të iniciohet procedurë disiplinore për shkak që mungesa në punë nuk ka qenë në vullnetin tonë por ka qenë për shkak të caktimit të masës së arrestit shtëpiak nga gjykata.

Lidhur me përgjegjësin disiplinore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i'u referua Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 45 ku është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Neni 46, ka trajtuar shkeljet disiplinore ku konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, ndërsa paragrafi 3 dhe 4 i nenit 46 të këtij ligji, ka trajtuar se cilat shkelje konsiderohen shkelje të rënda dhe të lehta, duke përcaktuar se: "Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmblidhja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmblidhjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmblidhjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë".

Andaj bazuar në këtë Kolegji i Këshillit, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve si dhe duke shqyrtuar ligjshmërinë e Vendimit me Nr. 01/016/01-0097492/2022 të datës 07.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Pejës, konstaton se ky vendim është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale për faktin se Komisioni nuk ka bërë kualifikimin e saktë të shkeljes disiplinore e për të cilën çështje ka kompetencë dhe është i obliguar sipas dispozitave të nenit 8 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se: „Masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Ligjit shqiptohen nga Komisioni Disiplinor, nëse nëpunësi civil ka bërë shkelje të dispozitave të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit” rrjedhimisht në bazë të kësaj Komisioni disiplinor me datë 07.10.2022 ka nxjerr vendime të ndara veç e veç por të gjitha me numër protokollit të njëjtë gjegjësisht me numër Nr.01/016/01-0097492/2022 përmes të cilave vendime ankuesve veç e veç i është shqiptuar masë disiplinore "ndalimi i 20% e pagës për periudhën dy (2) muaj, pa u qartësuar se shkelja e supozuar që është shqiptuar ndaj ankueseve a është konsideruar shkelje e lehtë apo e rëndë e paraparë me nenin 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Po ashtu Komisioni Disiplinor i Komunës së Pejës ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se „Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. „Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura” dhe 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore” dhe në kundërshtim me neni 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se; „Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 4.2. Shkallën e fajësisë; 4.3. Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; 4.4. Përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit” sepse në rastin

konkret Komisioni nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat dhe faktet, rrjedhimisht nuk ka arritur të vërtetoj me asnjë prove përgjegjësinë e ankuesëve shkaqet, rrethanat dhe pasojat e kryerjes së shkeljes, respektivisht nuk ka marrë për bazë deklaratat e ankuesëve të dhënat e ofruara dhe dokumentet e bashkangjitura, po ashtu në vendim përcaktohet se ankuesja ka munguar në punë nga data 11.08.2021 deri më datë 10.09.2021 ndërsa inicimi i procedurës disiplinore është për bërë për periudhën 15.07.2021 deri më datë 10.09.2021, rrjedhimisht ky vendim nuk pasqyron asnjë gjendje faktike dhe juridike për faktin se nuk ka arritur të arsyetoj me asnjë prove faktin se mungesat e ankuesëve a ka qenë si rezultat i vullnetit të tyre respektivisht nuk ka konstatuar se këto mungesa kanë qenë apo jo të paarsyeshme.

Komisioni Disiplinor nuk ka shqyrtuar faktin se kush mund të inicoj procedurë pranë këtij komisioni në kuptim të nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafët 4.1, 4.2 dhe 4.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit; 4.3. me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore"*, rrjedhimisht Komisioni nuk ka shqyrtuar faktin se edhe në kërkesën e datës 09.09.2022 të Menaxherit të Personelit për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesëve nuk është arsyetuar se cilat nga shkeljet e rënda të përcaktuara me nenin 46 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kanë bërë ankuesit. Po ashtu Komisioni Disiplinor nuk ka shqyrtuar mundësin që a duhet të ndërmerren veprimet juridike duke pasur parasysh dispozitat e nenit 85 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në faktet e lartcekura dhe duke qenë se vendimi i kundërshtuar me ankesë, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesëve është e bazuar dhe rrjedhimisht vlerësoi që kjo çështje ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast të Komisioni Disiplinor i Komunës së Pejës, i cili është i obliguar që të rishqyrtoj çështjen në fjalë dhe i njëjti në riprocedurë duhet të merr veprime juridike për shqyrtimin e drejtë të kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesëve, të marr parasysh pikëpamjet juridike të këtij vendimi dhe t'i eliminoj të metat e konstatuara të aktit administrativ si dhe në fund të nxjerr vendim në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht të bazohet në *Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; Shkallën e fajësisë; Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; Përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit, siç parashihet me nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1118/2022,

**Sabile AVDYLI**  
*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**  
*Malsore Gashi Bajraktari*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesve,
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.